

# MBULIMI I KOSTOS

DORACAKU PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE/TAKSAVE  
PËR PROCEDURAT ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
PARIMIN E MBULIMIT TË KOSTOS



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Confederation  
Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO



**IFC**

International  
Finance Corporation  
WORLD BANK GROUP

# MBULIMI I KOSTOS

DORACAKU PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE/TAKSAVE  
PËR PROCEDURAT ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
PARIMIN E MBULIMIT TË KOSTOS



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Confederation  
Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO



**IFC**

International  
Finance Corporation  
WORLD BANK GROUP



# Mbulimi i Kostos

DORACAKU PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE/TAKSAVE  
PËR PROCEDURAT ADMINISTRATIVE BAZUAR  
NË PARIMIN E MBULIMIT TË KOSTOS

Dizajni: Envinion

Ky doracak është përgatitur si pjesë e asistencës teknike të ofruar nga Grupi i Bankës Botërore/Bashkëpunimi Ndërkombëtar Financiar (IFC) përmes Projektit për Klimën e Investimeve, i cili financohet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike SECO

Në rast të pyetjeve në lidhje me Dorackun për Mbulimin e Kostos dhe për kërkesa për mbështetje për përdorimin e këtij Doracku, ju lutemi kontaktoni Departamentin e Zyrës së Kryeministrit në vijim:

Zyra e Planifikimit Strategjik

Zyra e Kryeministrit

[zps.zkm@rks-gov.net](mailto:zps.zkm@rks-gov.net)

---

# PËRMBAJTJA

## 6 | LISTA E SHKURTESAVE

### 1. HYRJE

### 2. ÇFARË ËSHTË PARIMI I MBULIMIT TË KOSTOS?

- 9 | Kush duhet ta bëjë matjen?

### 3. KRYERJA HAP PAS HAPI E LLOGARITJËS

- 11 | HAPI 1: Rishikimi i bazës ligjore dhe marrja e vendimit për aplikim të parimit për mbulimin e kostos
- 12 | HAPI 2: Ndarja e lëshimit të PA në aktivitete të ndryshme
- 13 | HAPI 3: Kostimi i lëshimit të PA dhe plotësimi i modelit të mbulimit të kostos  
Identifikimin dhe kategorizimin e kostove në kosto direkte dhe indirekte  
Matjen e kostove direkte dhe indirekte dhe atribuimin e kostove indirekte në kosto totale për nxjerrjen e PA  
Plotësimi i modelit të mbulimit të kostos
- 18 | HAPI 4: Finalizimi i aktit ligjor përkatës
- 18 | HAPI 5: Rishikime të rregullta të kostos

### SHTOJCAT

- 19 | Shtojca 1: Skedari i modelit (faqe 21 te Doracakut pas Sekdarit te modelit)  
Vizitoni faqen e internetit: <https://kryeministri.rks-gov.net/> Me nderime,

---

# Lista e Shkurtesave

<b>ASK</b>	Agjencisë së Statistikave të Kosovës
<b>BA</b>	Barra administrative
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KD</b>	Koncept Dokument
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>L&amp;L</b>	Leje & Licenca
<b>MKS</b>	Modeli i kostimit standard
<b>OJQ</b>	Organizata jo-qeveritare
<b>PA</b>	Procedurat Administrative
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>ZPS</b>	Zyra për Planifikim Strategjik

---

# 1. Hyrje



Institucionet publike (ministritë dhe agjencitë e pavarura të nivelit qendror si dhe komunat) ofrojnë një gamë të larmishme shërbimesh administrative të quajtura Procedurat Administrative (PA) që përfshin lëshimin e lejeve, licensave (L&L), autorizimeve, certifikatave etj. Praktika e preferuar për përcaktimin e tarifave/taksave për procedurat administrative është mbulimi i kostos (cost recovery) i cili kërkon që taksat për lëshimin e PA-ve të pasqyrojnë dhe të mos tejkalojnë kostot e krijuara nga institucioni publik që lidhen me lëshimin e PA. Kjo praktikë është reflektuar edhe në kornizën ligjore të Kosovës. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave (Ligji Nr. 04/L-202), përkatësisht neni 18 i tij, thotë që taksat që aurotiteti kompetent mund të ngarkojë për një lejm nuk do të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin<sup>1</sup>. Në anën tjetër, ligji për procedurën e përgjithshme administrative (ligji Nr. 05/L 031), neni 12, paragrafi i parë thotë që për palën, procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve ku parashikohet ndryshe me ligj<sup>2</sup>. Kur pagesa është e parashikuar me ligj, ajo nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative<sup>3</sup>. Ndërsa, paragrafi i tretë i nenit 12 lejon organin publik që të vendosë përjashtimin e tërësishëm apo të pjesërishtë nga pagesa e përcaktuar me ligj.

Bazuar në këtë kuadër ligjor, institucionet publike mund të mos aplikojnë asnjë taksë për procedurën administrative ose mund të zbatojnë parime të mbulimit të plotë ose të pjesshëm të kostos kur vendosin taksën për lëshimin e PA. Prandaj, ky doracak do të fokusohet në parimet e mbulimit të plotë ose të pjesshëm të kostos dhe se si këto parime mund të përdoren në përcaktimin e tarifave ose taksave për PA.

Në praktikë, ka shqetësime se shumë nga këto taksat janë përcaktuar pa llogaritje të detajuara të kostos dhe si rrjedhim nuk ndjekin parimin e mbulimit të kostos. Prandaj, është e rëndësishme të dihet nëse tarifat ose taksat që janë përcaktuar nga institucionet publike të nivelit qendror (ministritë, agjencitë e pavarura) si dhe ato të përcaktuar nga pushteti lokal (komunat) për PA të trajtuara në nivel komunal pasqyrojnë parimin e mbulimit të kostos. Edhe nëse taksat e përcaktuara janë llogaritur në bazë të kostos së detajuar, këto taksat duhet të rishikohen për një interval të caktuar (zakonisht pesë vjeçar) në mënyrë që të dihet nëse ato janë përcaktuar në nivelin e duhur që do të mundësonte mbulimin e plotë ose të pjesshëm të kostos. Ky Doracak do të nxjerrë në pah kornizën gjithëpërfshirëse dhe metodologjinë e detajuar që mund të aplikohet për llogaritjen e kostove për përcaktimin e taksave (ose rishikimin e taksave që janë vendosur tashmë) për PA dhe ofron hapa të detajuar dhe një shembull se si mund të kryhet një llogaritje e tillë. Doracaku përfshin gjithashtu një mjet plotësues, siç është modeli i llogaritjes së mbulimit të kostos, i cili do t'i ndihmojë institucionet publike të mbledhin dhe të vendosin të gjithë informacionin në lidhje me kostot në këtë model i cili do të llogarisë koston e lëshimit të një PA në mënyrë automatike.

---

1 Ligjin mund ta gjeni në këtë link: <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967>

2 Ligjin mund ta gjeni në këtë link: <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

3 Paragrafi i dytë i nenit 12

---

## 2. Çfarë është parimi i mbulimit të kostos?

Parimi i mbulimit të koston nënkupton procesin kur institucionet publike (qendrore dhe lokale) dëshirojnë t'a ngarkojnë sektorin joqeveritar (bizneset, qytetarët dhe OJQ-të) me një pjesë (mbulimi i pjesëshëm i koston) ose të gjitha kostot (mbulimi i plotë i koston) e një aktiviteti të caktuar institucional, në këtë rast, kostot që janë shkaktuar gjatë kryerjes ose lëshimit të PA. Parimi i mbulimit të koston promovon gjithashtu politikë të qëndrueshme, transparente dhe të përgjegjshme lidhur me taksat për aktivitetet e sektorit publik dhe mbështet përdorimin e duhur të burimeve publike dhe burimeve nacionale.

Parimi i mbulimit të koston, synon të ketë përafërim midis shpenzimeve gjatë kryerjes së aktivitetit insitucional (në këtë rast kostot e përfshira në ofrimin e PA) dhe të ardhurave (të krijuara nga taksa për ofrimin e PA). Ky parim supozon se ka disa kosto që mund të ndahen në mënyrë specifike për një aktivitet (p.sh. ofrimi i PA) të vetme, ndërsa ka edhe kostot e tjera që mund të quhen ose klasifikohen si kosto të përgjithshme ose indirekte të cilat krijohen gjatë realizimit të një numri shërbimesh dhe aktivitetesh të tjera. Kjo metodë përcakton kostot totale, direkte dhe indirekte, të ofrimit të një PA. Kostoja totale (direkte dhe indirekte) e ofrimit të PA bëhet taksa që duhet të ngarkohet për lëshimin e PA. Taksa e mbulimit të koston duhet t'i ngarkohen aplikuesit të PA-ve (në këtë rast bizneset, qytetarët dhe/ose OJQ-të).

Ky doracak mund të përdoret nga të gjitha institucionet publike që lëshojnë PA (p.sh. ministritë, komunat<sup>4</sup> dhe agjencitë e pavarura) të cilat kanë një bazë ligjore dhe të mbështetur nga aktet nën-ligjore për të ngarkuar taksat për ofrimin e PA.

### Kush duhet ta bëjë matjen?

Stafi i institucioneve publike duhet të jenë përgjegjës për kryerjen e analizave të mbulimit të koston për vendosjen e tarifave për PA e lëshuara nga këto institucionet publike. Kjo do të thotë se, stafi i institucioneve publike duhet të ndjekin çdo hap të përcaktuar nga ky Doracak për të identifikuar dhe dokumentuar kostot e lidhura me lëshimin e PA dhe të përdorin rezultatet e kësaj analize në aktin ligjor që përcakton tarifat ose taksat për PA. Ata po ashtu janë të obliguar të rishikojnë llogaritjet e tilla të koston në afatin kohor të përcaktuar në këtë Doracak.

Megjithatë, çdo matje duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS) të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-së). ZPS-ja mbështet ministritë e linjës, komunat dhe agjencitë e pavarura me trajnime, mbështetje praktike dhe këshilla gjatë procesit të matjes për të siguruar që analiza e mbulimit të koston për vendosjen e taksës për ofrimin e AP të zbatohet në mënyrë konsistente dhe me kuadrin e përcaktuar në këtë doracak.

---

4 Për zbatimin e hollësishtëm të këtij Doracaku për komunat, ju lutemi shikoni faqen 11 të Manualit.

---

## **3. Kryerja hap pas hapi e llogaritjes**

Kjo pjesë e Doracakut ofron udhëzime praktike për çdo fazë/hap të procesit të llogaritjes së mbulimit të kostos për lëshim të PA.

### **HAPI 1: Rishikimi i bazës ligjore dhe marrja e vendimit për aplikim të parimit për mbulimin e kostos**

Hapi i parë është rishikimi i aktit ligjor që përcakton ofrimin e PA, krahasimi i tij me ligjet kornizë që rregullojnë ofrimin e PA (siç janë ligji për sistemin e lejeve dhe licensave<sup>5</sup> dhe ligji për procedurën e përgjithshme administrative)<sup>6</sup>. Këto rishikime do të ndihmojnë institucionin publik të përcaktojë:

- nëse ka një justifikim apo bazë ligjore për të ngarkuar një taksë për aplikim të PA; dhe nëse po,
- të vendosë a do të ngarkoj ndonjë taksë për aplikim të PA-së; dhe nëse po,
- a do të aplikohet taksa sipas parimit të plotë ose të pjesshëm të mbulimit të kostos?

Mbulimi i plotë i kostos do të thotë kur e gjithë kostoja e lëshimit të PA-së i ngarkohet aplikuesve, ndërsa mbulimi i pjesshëm i kostos nënkupton kur një pjesë e kostos (jo të gjitha) të lëshimit të PA-së i ngarkohet aplikuesve në formë të taksës. Mos aplikimi i ndonjë takse ndodhë kur institucioni publik vendos të mbulojë të gjithë koston e lëshimit të PA dhe nuk aplikon asnjë ngarkesë për aplikuesit e tij (p.sh kur taksa për aplikim të një PA është 0 euro).

### **HAPI 2: Ndarja e lëshimit të PA në aktivitete të ndryshme**

Nëse institucioni publik identifikon se ekziston një bazë ligjore për të aplikuar taksa për lëshimin e PA dhe vendosin të ngarkojnë taksa në bazë të mbulimit të plotë ose të pjesshëm të kostos, atëherë institucioni publik si hap i radhës duhet të bëjë ndarjen e trajtimit të PA në aktivitete të ndryshme. Zbërthimi i trajti-

mit të PA në aktivitete të veçanta nënkupton zbërthimin e trajtimit të PA-së në procese të ndryshme në të cilat institucioni duhet të përfshihet gjatë lëshimit të një PA. Si shembull, aktivitetet e mëposhtme mund të përfshihen në vlerësimin e aplikimit për një leje të caktuar:

- Pranimi i aplikacionit (me dokumente bashkangjitur)
- Kontrollimi i saktësisë së informacionit të ofruar në aplikacion si dhe dokumentet e bashkangjitura
- Vlerësimin e aplikimit
- Marrja e vendimit
- Njoftimin e vendimit tek aplikuesit

Siç mund të parashikohet, çdo aktivitet individual do të ketë një kosto që i atribuohet. Zbërthimi i trajtimit të PA në aktivitete të veçanta lejon lidhjen e kostove për secilin aktivitet që të jetë e mundur idenfitikimi dhe kalkulimi i kostos totale të lëshimit të një PA. Ky proces do të shpjegohet me shumë detaje në hapin 3.

5 Ligji Nr. 04/L-202

6 ligji Nr. 05/L-031

### **Shembulli:**

Në kuadër të procesit të thjeshtimit të PA, është përgjendhur licenca për import dhe shitje me shumicë të cigareve si procedurë prioritare për matjen e taksës sipas kostos të mbulimit. Le të supozojmë se aktet juridike që rregullojnë dhënien e licencës (që janë Ligji Nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin si dhe Udhëzim Administrativ (MTI) nr. 04 / 2016 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për subjektet që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij) janë të vlerësuara dhe krahasuara me ligjet kornizë që përcaktojnë PA dhe është evidentuar se ka arsyetim ligjor të vendosjes së taksës për këtë licencë. Po ashtu, le të supozojmë se Ministria ka vendosur të aplikojë parimin e mbulimit të kostos së plotë në përcaktimin e taksës së aplikimit për këtë licencë. Aktivitetet e mëposhtme janë përcaktuar për trajtimin e kësaj PA:

- Pranimi i aplikacionit (me dokumente bashkangjitur)
- Kontrollimi i saktësisë së informacionit të ofruar në aplikacion si dhe dokumentet e bashkangjitura
- Vlerësimin e aplikimit nga një komision i veçantë
- Marrja e vendimit
- Njoftimin e vendimit tek aplikuesit

### **HAPI 3: Kostimi i lëshimit të PA dhe plotësimi i modelit të mbulimit të kostos**

Pasi institucionet publike të kenë zberthyer lëshimit të PA-së në aktivitete të veçanta, kostot përkatëse duhet të identifikohen dhe t'i atribuohen lëshimit të PA-së. Ky hap përfshin tri detyra të ndryshme:

- Identifikimin dhe kategorizimin e kostove në kosto direkte dhe indirekte
- Matjen e kostove direkte dhe indirekte dhe atribuimin e kostove indirekte në kosto totale për nxjerrjen e PA
- Plotësimi i modelit të mbulimit të kostos

#### **Identifikimi dhe kategorizimi i kostove në kosto direkte dhe indirekte**

Kostoja që lidhet për lëshimin e PA mund të ndahet në kosto direkte dhe indirekte.

**Kosto direkte:** janë kostot që rrjedhin nga aktivitetet ose proceset që institucionet publike duhet të ndërmarrin gjatë lëshimit të PA.

Këto janë shpenzime që mund t'i atribuohen drejtpërdrejt një PA, duke qenë:

- Kosto e drejtpërdrejtë të zyretarëve që janë të përfshirë në ofrimin e PA (koston e pagave të zyrtarëve që ofrojnë PA, kohën e shpenzuar për të përfunduar shërbimin). Kostot direkte më të zakonshme janë pagat (bruto) e stafit që janë të angazhuar në aktivitetet e përcaktuara në hapin 2.
- Shpenzimet materiale direkte që janë përdorur gjatë ofrimit të PA (në qoftë se ekzistojnë të dhënat e zberthyera në dispozicion për këtë); dhe ndonjë shpenzim tjetër që lidhet ose përdoret drejtpërdrejt me lëshimin e PA (si p.sh. letra speciale për printimin e certifikates me elemente të sigurisë).

Këto kosto direkte duhet të mblidhen në mënyrë që të nxirret kostoja totale direkte për një PA.


**Kosto indirekte** në anën tjetër janë shpenzime që nuk mund t'i atribuohen drejtpërdrejt një PA por megjithatë janë kosto që mbështesin lëshimin e PA.

Kostot indirekte janë klasifikuar si kosto të përbashkëta:

- Komunali (ujë, pastrimi, rrymë, ngrohje);
- Furnizime me materail të ndryshme në zyre
- Shpenzime për telefon, karburant për automjete

- Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve dhe pajisjeve të përdorura për të siguruar shërbimin;
- Qiraja
- Zhvlerësimi indërtesave ku shërbimet janë ofruar pajisjeve etj.

Figura 1: Kostot direkte dhe indirekte



## Matja e kostove direkte dhe indirekte dhe atribuimi i kostove indirekte në kosto totale për nxjerrjen e PA

Në parim, llogaritja e mbulimit të koston për PA kërkon që matja të bëhet për një shërbim ose për një PA. Kështu që, procesi i llogaritjes së koston analizon lëshimin e një PA. Kjo rrugë është ndjekur edhe nga ky Doracak. Megjithatë, nëse kjo nuk është e mundur në praktikë, atëherë procesi i llogaritjes së koston mund të kryhet duke shikuar koston e ofrimit të shërbimit për një periudhë kohore të caktuar<sup>7</sup>.

**Kostot direkte:** Kostoja direkte, siç e përmendëm më sipër, përbëhen nga kostoja e pagave të zyrtarëve që ofrojnë PA, kohën e shpenzuar për të përfunduar shërbimin, si dhe ndonjë shpenzim direkt (p.sh materialet) që është bërë gjatë ofrimit të PA. Përcaktimi i koston direkte që vjen nga pagat bruto të stafit varet nga niveli i pagës (me orë) i personelit të përfshirë dhe kohën e shpenzuar për të kryer çdo aktivitet të lidhur me ofrimin e PA. Për këtë arsye, insitucioni publik duhet të përcaktojë se sa kohë personeli i tyre shpenzon për çdo aktivitet për lëshimin e një PA. Nëse koha e nevojshme për të përfunduar aktivitetet për lëshimin e një PA ndryshon nga një aplikimi në tjetrin, insitucioni publik duhet të marrë kohën mesatare që nevojitet për të përfunduar çdo aktivitet gjatë të lëshimit të një PA. Nga ana tjetër, paga bruto për orë llogaritet duke e ndarë pagën mujore bruto të stafit në 168 orë që konsiderohet si orë standarde e punës në muaj. Pasi koha totale e nevojshme për të përfunduar çdo aktivitet dhe paga bruto e personelit të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve të futet në model, shablloni do të llogarisë automatikisht pagat bruto për orë dhe koston direkte për çdo aktivitet të përfshirë. Informacioni për pagën bruto të personelit mund të merret nga Departamenti i Burimeve Njerëzore ose nga Departamenti i Financave.

**Kosto indirekte:** Të gjitha koston indirekte, nga ana tjetër, mund të merren nga Departamenti i Financave të insitucionit publik përkatës. Të gjitha koston indirekte të përmendura në hapin 2 janë në dispozicion nga Departamenti i Financave dhe këto kosto ose shpenzimet duhet të kërkohen prej tyre. Koston indirekte ose shumat e shpenzimeve që lidhen me kosto indirekte të përmendura në hapin 2 duhet të jepen për një vit.

Kostoja indirekte së pari duhet të ndahet dhe të shpërndahet në mënyrë proporcionale të PA dhe pastaj duhet të i shtohet koston direkte pasi kostoja indirekte shoqërohet jo vetëm me lëshimin e PA por për të gjitha aktivitetet e insitucioneve publike. Përcaktimi i alokimit të koston indirekte në ofrimin e një PA bëhet automatikisht nga modeli i mbulimit të koston duke marrë një proporcion të caktuar të koston indirekte bazuar në kohën e shpenzuar të stafit gjatë trajtimit të PA në raport me të gjithë kohën e stafit. Më pastaj, kjo kosto indirekte i atribuohet në mënyrë automatike koston totale të lëshimit të një PA. Për të ndarë koston indirekte në një kosto totale të lëshimit të PA, duhet të shtojmë gjithashtu numrin e stafit total që punon për një insitucion publik.

Kostoja e lëshimit të PA është thjeshtë koston, direkte dhe ato indirekte, të shkaktuara nga ofrimi i shërbimit (d.m.th. lëshimi i një PA).

## Plotësimi i modelit të mbulimit të koston

Të gjitha koston e identifikuar të mbulimit të koston duhet të futet në një shabllon ose model për mbulimin e koston në mënyrë që të plotësohen llogaritjet e koston. Modeli është i ndarë në dy faqe: faqja e parë ka të bëjë me koston direkte dhe faqja e dytë për koston indirekte. Faqja e parë e shabllonit përveç përllogaritjeve financiare përfshinë edhe infor-

<sup>7</sup> Pasi të identifikohen dhe plotësohen të gjitha koston për ofrimin e shërbimit, kosto totale mund të pjesëtohet me numrin e aplikimeve të dorëzuara për atë periudhë kohore për të përcaktuar një taksë për mbulimin e koston për një njësi shërbimi. Një periudhë standarde kohore do të ishte në v



macionin për emrin e procedurës, aktin ligjor që rregullon lëshimin e PA, numrin vjetor të aplikimeve (opsionale).

Faqja e parë e modelit në fakt ka të bëjë me koston direkte dhe koston totale. Në kolonën e parë të faqes së parë, përdoruesi duhet të shtojë të gjitha aktivitetet e parashikuara në hapin 2. Në kolonën e dytë të kësaj faqe, institucioni publik duhet të shtojë numrin e zyrtarëve që janë të përfshirë në ofrimin e shërbimit për leje/licencë (për një aplikim). Në kolonën e tretë të kësaj faqeje institucioni publik duhet të shtojë kohën së shpenzuar për të përfunduar shërbimin për leje/licencë (total në orë për të gjithë zyrtarët). Kolona e katërt llogaritet automatikisht dhe nuk kërkohet të shtohen të dhëna. Në kolonën e pestë, përdoruesi duhet të shtojë pagën bruto të personelit të angazhuar për çdo aktivitet. Kolona e gjashtë llogaritet automatikisht koston e çdo aktiviteti dhe nuk ka nevojë të ofrohet ndonjë input. Tek kolona e fundit që ka të bëjë me komentet, institucioni publik mund të ofrojë detaje të ndryshme. Për shembull, nëse është i angazhuar personal me paga të ndryshme në të njëjtin aktivitet, kjo mund të shpjegohet në kolonën e komenteve. Në këtë rast, në kolonën e pestë duhet të shënohet paga mesatare bruto e punonjësve të ndryshëm. I gjithë ky informacion duhet të plotësohet për çdo aktivitet në model. Në rreshtin e fundit të pjesës të dedikuar për aktivitetet, përdoruesi mund të shtojë çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me lëshimin e PA (të tilla si kostoja e letrës speciale për printimin e certificates me elemente të sigurisë. Pjesa tjetër e faqes së parë llogaritet automatikisht. Kjo përfshinë koston totale direkte dhe koston totale indirekte (e cila vjen nga faqja e dytë) dhe koston totale.

Faqja e dytë e shabllonit ka të bëjë me koston indirekte. Të gjithë parametrat e koston indirekte të marra nga Departamenti Financave duhet të vendosen në faqen e dytë të shabllonit. Në kolonën e parë, institucioni publik duhet të shtojë të gjithë parametrat e koston indirekte, në kolonën e dytë shumën e shpenzimeve për çdo parametër të koston indirekte. Ndërsa në kolonën e tretë numrin total të personelit që punon për institucionin përkatës. Kolona e fundit që ka të bëjë me kalkulimin e koston indirekte për një punonjës llogaritet automatikisht. Kështu që nuk ka nevojë të shtoni ndonjë hyrje.

Pasi të plotësohen të gjitha këto inpute, kostoja totale direkte, kostoja totale indirekte dhe kostoja totale për lëshimin e PA do të kalkulohet nga modeli dhe do të paraqitet në faqen e parë të modelit. Në përgjithësi, në qoftë se mbledhja e të dhënave do të jetë e mirë, puna me modelimin e koston do të jetë mjaft e thjeshtë.

**Shembulli:**

Kalkulimi i kostos e licencës për import dhe shitje me shumicë të cigareve sipas parimit të mbulimit të kostos

**Kosto direkte:** Tabela e parë ofron listën e aktiviteteve dhe inputeve (koha e shpenzuar, paga bruto e personelit të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve dhe shpenzime të tjera që lidhen me ofrimin e PA.

**Tabela 1:** Kosto direkte e licencës për import dhe shitje me shumicë të cigareve

Parametrat e kostos	Aktivitete				
	Pranimi i aplikacionit	Kontrollimi i saktësisë së informacionit	Vlerësimi i aplikimit	Marrja e vendimit	Njoftimi për vendimin
Koha totale (në orë)	1	1	6	2	2
Paga bruto (EUR)	534	534	580	1,033	516
Shpenzimet te tjera			0		

**Kosto indirekte:** Në mënyrë të ngjashme, tabela 2 mbledh informacionin e mëposhtëm mbi kostot indirekte

**Tabela 2:** Kosto indirekte të licencës për import dhe shitje me shumicë të cigareve

Komunali (ujë, pastrimi, rrymë, ngrohje)	76 467 €
Telefon	31 025 €
Qiraja	45 197 €
Furnizime me material të ndryshëm në zyrë	22 538 €
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve dhe paisjeve të përdorura për të siguruar shërbimin	56 837 €
Karburant për automjete	26 008 €
Shpenzimet e mirëmbajtjes për automjete	34 642 €
Shpenzime të tjera indirekte	1 971 €
<b>KOSTOJA TOTALE INDIREKTE</b>	<b>294 686 €</b>
Numri total i zyrtarëve në Ministri	205

Pasi të jetë futur i gjithë ky informacion, modeli do të llogarisë automatikisht, totalin e kostos direkte, totalin e kostos indirekte (si dhe koston indirekte për një punonjës) dhe do të reflektoj një pjesë proporcionale të kostos indirekte dhe do të llogarisë koston totale për lëshimin e AP.

#### HAPI 4: Finalizimi i aktit ligjor përkatës

Kostoja totale e identifikuar nga modeli i mbulimit të koston duhet të përdoret dhe të pasqyrohet në aktin ligjor që rregullon vendosjen e taksës. Nëse kostoja totale nuk është një numër absolut, atëherë institucionet mund të bëjnë rrumbullakësimin në shifrën absolute më të afërt dhe ta përdorin atë shifër në tekstin ligjor.

#### HAPI 5: Rishikime të rregullta të koston

Në parim, institucionet publike duhet të rishikojnë vlerësimet e tyre të koston herë pas here, në mënyrë që të pasqyrojnë ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në parametrat e koston në

taksën për aplikim të PA-së. Parametrat e koston në parim mund të ulen ose rriten për shkak të inflacionit ose për shkaqe të tjera. Në këtë rast, taksat për PA mund të ndryshohen nëse rishikimi i vlerësimit të koston tregon se kostoja totale për lëshimin e PA është rritur apo ulur. Megjithatë, çdo ndryshim në taksa për PA kërkon edhe rishikim të aktit ligjor që rregullon PA dhe aplikimin e taksave. Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, rishikimet e mbulimit të koston zakonisht bëhen çdo pesë vite.

#### Aplikimi i mbulimit të koston në komuna

*Komunat gjithashtu mund ta përdorin Doracakun në të njëjtën mënyrë si institucionet e nivelit qendror. Megjithatë, politika e komunave ose qeverisë qendrore është që të ketë një taksë ose tarifë të njëjtë për të gjitha komunat për PA të caktuara të lëshuara nga komunat, prandaj duhet të kryhen disa llogaritje shtesë. Në parim, meqenëse ka komuna të ndryshme me madhësi, popullsi gjeografike dhe zhvillim ekonomik, mund të priten variacione të mëdha për sa i përket koston, sidomos nëse ndiqen parimet të mbulimit të koston në plotëni për komunat e ndryshme meqenëse secila komunë mund të ketë kosto të ndryshme direkte dhe indirekte. Nëse komunat ose qeveria qendrore preferojnë të kenë vetëm një taksë të njëjtë për një shërbim/PA në të gjitha komunat, atëherë llogaritja e mbulimit të koston mund të bëhet duke parë koston e komunave të caktuara si mostër. Ekzistojnë teknika të ndryshme të mostrave të përdorura në hulumtime. Në këtë rast, mund të përdoret mostra e stratifikuar. Mostra e stratifikuar përfshinë ndarjen e popullsisë (d.m.th. 38 komuna) në shtresa ose grupe të ndryshme, (si p.sh. një grup nga komunat e vogla rurale dhe një tjetër nga komunat më urbane dhe më të mëdha) dhe një mostër e komunave merret nga secila shtresë ose grup<sup>8</sup>. Vendosja e parametrave të koston për secilin komunë të përzgjedhur nga mostra në model të mbulimit të koston do të rezultojë në rezultate mjaft të ndryshme. Më pas, këto rezultate të mbulimit të koston për ato komuna që janë përzgjedhur duhet të kombinohen dhe të nxjerret një mesatare në mënyrë që të kemi një tarifë ose taksë që mund të aplikohet në të gjitha komunat. Edhe nëse me këtë taksë të vendosur për një PA disa komuna mund të mbledhin më shumë të ardhura sesa kosto e krijuar dhe disa të tjera nuk mund të mbulojnë koston e tyre (llojshmëria e taksave mund të reflektojë në mënyrë më adekuate koston për secilën komunë), një situatë e tillë mund të mos jetë e pëlqyeshme nga komunat dhe/ose nga qeveria e nivelit qendror gjatë përcaktimit të taksave të PA.*

8 Sipas kësaj, disa komuna mund të zgjidhen nga grupi i komunave të vogla rurale dhe disa nga komunat më urbane dhe më të mëdha.

---

## 4. Shtojcat

## Shtojca 1: Skedari i modelit



